

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Skandal / SHISH i Vlora Hysenit përgjoi policinë dhe prokurorë të SPAK për llogari të grupeve kriminale. Kryeagjentja tentoi t'ia hedhë SPAK-ut: Gysin e kisha rekrutuar si spiun
ADRESA	https://prapaskena.com/2026/09/24/skandal-shish-i-vlora-hysenit-pergjoi-policine-per-llogari-te-grupeve-kriminale-sabotoi-operacionet-per-kapjen-e-personave-ne-kerkim-kryeagjen-tja-tentoi-tia-hedhe-spak-ut-gysin-e-kisha-rekrutua/
BURIMI	prapaskena.com
GJENDJA	edited

KOHA


KAPUR NGA NE	24 shtator 2026, 06:31:14 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
LEXUAR NGA FAQJA	23 shtator 2026, 22:00:00 UTC <i>Portali nuk e deklaroi datën në asnjë formë makinë-lexueshme; kjo është ora e shkruar për njeriun, e lexuar nga faqja me meto dën text_date. Dritarja: 23 shtator 2026, 21:59:00 UTC → 24 shtator 2026, 06:31:14 UTC. Kalon nga një rregull i yni që mund t ë gabojë, prandaj shfaqet si e lexuar dhe jo si e deklaruar.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	128bf5726153a64c811cfa3d65f6d209be0d5bde038601d75caafcd9a4a83c0d
TEKSTI	410463e5deda3bb9988b12badedb81851d90989443a94e679ab7c14e479103c3
PAMJA	bca54c7da320003619bc2427e6a0db8152b500dd22569f67d4d54a065e39694f

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	34ea2a5ddca9b16ecb1aec64fa77c2ebd660a772144c61965845a89e86f7f61b
E MËPARSHMJA	a6155a6995a42474d2be04682f03bfaff7eb84e3211d451a13a4054d87d348e7
RRËNJA MERKLE	03df4d9a80cdf44936c77c8ec22002d13999b9b6a89688aa248bd30aec08395f
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/34ea2a5ddca9b16ecb1aec64fa77c2ebd660a772144c61965845a89e86f7f61b>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Skandal / SHISH i Vlora Hysenit përgjoi policinë dhe prokurorë të SPAK për llogari të grupeve kriminale. Kryeagjentja tentoi t'ia hedhë SPAK-ut: Gysin e kisha rekrutuar si spiun

Kryesore

Publikuar: 24/09/2026

f X



Merr të tjera përmasa skandali i vendosjes së Shërbimit Informativ Shetëror, kolonës së sigurisë kombëtare, në shërbim të personave në kërkim nga kryeagjentja Vlora Hyseni, e cila akuzohet nga SPAK për kraheje e autorit të krimit dhe nxjerrje të sekretit shtetëror.


Teksa policia monitoronte dhe ndërmernte operacione për kapjen e personave në kërkim nga SPAK dhe goditjen e grupeve kriminale, segmente të SHISH, me porosi të Vlora Hysenit, mësohet se survejonin dhe përgjonin përfaqësues të Policisë së Shtetit, me qëllim shantazhimit të tyre.

Sipas burimeve, janë përgjuar dhe survejuar me qëllim shantazhi edhe një prokuror i SPAK-ut që po hetonte Gys Agasin si dhe gjyqtar të GJKKO.

Disa operacione policore dyshohet se janë sabotuar pikërisht nga SHISH, të cilin Vlora Hyseni rezulton se e kishte devijuar nga

Me të lexuarat

500 mesazhe /



"Do përfundojmë keq shpirt". Si raportonte kryeagjentja Vlora Hyseni te Gys Agasi Mauro



Borghi që helmojnë shqiptarët me djathë me baktera të SHISH i Vlora



Hysenit përgjoi policinë dhe prokurorë të SPAK për grupet ma...



drogë / Arrestohet në Rusi Shpëtim Aliu, një nga "kokat" e Dokumenti/



Vlora Hyseni ishte propozuar në gusht nga Franca për gradën "Kalorës" të Urdhrit Kombë...

misioni ligjor, duke e vendosur në shërbime të grupeve kriminale të shpallura nga SPAK, si dhe interesave të saj private, monetare dhe shpirtërore. Agjentë të SHISH mësohet se kanë përgjuar dhe përndjekur drejtues policie, të cilët Vlora Hyseni i shihte si armiq që do t'i arrestonin bandillët e saj në kërkim.

Në vend të bashkëpunimit për luftën kundër krimit të organizuar, Vlora Hyseni e kishte pozicionuar SHISH në llogoren e personave në kërkim kundër Policisë së Shtetit. Sipas burimeve, për përgjimin e policitë, Vlora Hyseni kishte angazhuar J. K., me pozicion drejtues në SHISH. Ndërkaq, mendimi dhe tendeca e Vlora Hysenit për t'u hakmarrë ndaj atyre që i hapën dosje dhe i arrestuan njeriun e saj të zemrës, Gys Agasit, reflektohet edhe në komunikimet e saj me Agasin, pjesë e dosjes së SPAK-ut.

Teksa Agasi ishte në kërkim nga SPAK-u dhe po monitorohej nga policia, kryespiunia i shkruan; ***“Krejt këta njerëz që na kanë bërë çka na kanë bërë dua që të paguajnë. Zemër, thjesht duhet të koncentrohemi te halli jot. Të gjithë ne. Do përfundojmë keq, shpirt”***. Këto komunikime tregojnë jo vetëm gatishmërinë e drejtueses së SHISH për t'a ndihmuar dhe qëndruar pranë ndaj Agasit, por edhe për t'u hakmarrë ndaj 'armiqve' të tij.

Nga komunikimet e rikuperuara nga SPAK në një telefon të sekustruar, rezulton se Vlora Hyseni qante hallet dhe raportonte te Agasi edhe për takimet sekrete me shefat e shërbimeve informative partnere, por diskutonte edhe për zhvillimet politike dhe për emërimet që kishte ndërmend Rama të bënte. Kryetarja e SHISH i raportonte Agasit edhe për takimet që bënte me krerët e institucione shqiptare për çështje të sigurisë kombëtare dhe çështje të tjera.

Hyseni i jepte Agasit dosjet sekrete të SHISH. Nuk ka ende të dhëna për përmbajtjen e tyre, por besohet se mund të jenë informacione të mbledhura nga SHISH për trafiket, gjurmimin e figurave të krimit dhe veprimtari të tjera që janë pjesë e fushës së veprimit të SHISH. SPAK i ka gjetur disa nga materialet sekrete në makinën e Gys Agasit.

Më 18 shtator Vlora Hyseni është marrë nga agjentët e Byrosë Kombëtare të Hetimit për tu marrë në pyetje si person në dijeni, teksa kërkesa e SPAK për arrestimin e saj kishte rreth 5 ditë që priste vendimin e Gjykatës së Posaçme. Kryespiunia ka pranuar kontaktet me Agasin, por thotë se qëllimi ka qenë për shkak të detyrës së saj. Pra, sipas Vlora Hysenit, Ergys Agasin e kishte bërë bashkëpunëtor të Shërbimit Informativ për të goditur grupet kriminale, ndërsa komunikimet thotë se i kishte vetëm në distancë pa e takuar asnjëherë fizikisht.

SPAK paraqet një panoramë krejtësisht tjetër nga ajo që e konsideron si alibi të Hysenit. Prokuroria e Posaçme thotë se ishte Agasi ai që kërkonte informacione dhe i diktonte ato që i

duheshin, dhe jo Hyseni. Vetë Ergys Agasi ka pranuar se dokumentet sekrete i kishte lënë me qëllim në makinën e tij, në mënyrë që SPAK t'i gjente kur të shkonte për kontrolle, siç dhe ndodhi.

Kur u pyet në mes të shtatorit, Vlora Hyseni nuk e kishte një shpjegim për këto materiale të dala jashtë institucionit, duke thënë se do të kthente një përgjigje konfidenciale me shkrim.

Nga ana tjetër, SPAK ka gjetur mbi 500 komunikime në celular të Ergys Agasit dhe Vlora Hysenit, nga fundi i qershorit deri më 26 gusht kur ai u arrestua në Durrës, të gjitha përmes aplikacionit të enkriptuar SIGNAL. Bisedat, sipas prokurorëve Altin Dumani dhe Bledar Maksuti tregojnë një lidhje shumë më të afërt sesa, siç e cilësojnë ata, me një "të ashtuquajtur bashkëpunëtor".

SPAK disponon edhe pamje filmike të takimeve dhe mes tyre që rrëzojnë pretendimin e Hysenit se me Agasin ka patur vetëm biseda telefonike në cilësinë e bashkëpunëtorit. Ndërkohë mësohet se një pjesë të kohës që ishte në kërkim për dosjen e AKSHI-t, ka qëndruar pranë vilave qeveritare në Durrës, ku dyshohet se është ndihmuar nga Hyseni për t'iu shmangur arrestimit. Gjithashtu ka dyshime, por nuk është e konfirmuar, se Agasi ka përdorur makinën e Vlora Hysenit gjatë kohës kur ishte në kërkim.

Institucioni i sekreteve në Shqipëri, kolona kryesore e sigurisë kombëtare, sipas dosjes së SPAK është vënë në shërbim të krimit të organizuar, korrupsionit dhe paligjshmërive, duke kompromentuar rëndë sigurinë kombëtare dhe besueshmërinë e SHISH në raport me partnerët kryesorë, amerikanët dhe izraelitët.

TAG:

Gys agasi

Pergjime

Policia

Shish

Vlora hyseni

Të ngjashme

Mbushi Europën me drogë / Arrestohet në Rusi Shpëtim Aliu, një nga "kokat" e rrjetit të trafikut ndërkombëtar të kokainës

Çifti Brunilda Isufi dhe Mauro Borghi që helmojnë shqiptarët me djathë me baktere të rrezikshme, AKU mjaftohet me një gjobë ndaj kompanisë INITALY ...

500 mesazhe / "Do përfundojmë keq shpirt". Si raportonte kryeagjentja Vlora Hyseni te Gys Agasi për takimet me krerët e shërbimeve partnere dhe sur...

Prapaskena

Copyrights

Kategoritë

'Prapaskena' lindi si një nismë e një grupi gazetarësh me përvojë dhe plotësisht të pavarur nga çdo parti politike, grup interesash apo klane biznesi, me qëllim për të thënë çdo të vërtetë të guximshme me interes publik. 'Prapaskena' është një media e lirë dhe e pakompromis, e cila ka si qëllim informimin e opinionit publik në mënyrë të paanshme, profesionale dhe në dritën e të vërtetës, mbi çështje që lidhen me korrupsionin politik, krimin, pandëshkueshmërinë, grabitjen e pasurive publike, mbi reformat, sfidat kombëtare dhe lidhjet e padukshme mes partive politike, mediave të njësura me interesat klienteliste, krimit dhe biznesit jo të ndershëm, të cilët në bashkëpunim përvetësojnë paratë dhe pasuritë publike.'

Çdo kopjim, përdorim apo riprodhim i paautorizuar i këtij materiali është i ndaluar dhe mund të sjellë ndjekje ligjore. Ju lutemi respektoni punën dhe përpjekjen tonë duke mos e shkelur këtë parim.

[KREU INVESTIGIM](#)

[KRIM & KORRUPSION](#) [DOSJE ROZË](#)

[KRYESORE](#) [POLITIKË](#) [EKONOMI](#)

[ANALIZË](#) [RAJON](#) [KULTURË](#) [SPORT](#)



Email: [\[email protected\]](#)

Copyright © 2025. All Rights Reserved by Prapaskena

[Privacy Policy](#) | [Cookies](#)

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.